



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE

Himarë, më 22.06.2023

Njoftim për konsultim publik

Titulli dhe kodi i projektit:

“Menaxhimi, Interpretimi dhe Plani i Eksperiencës së vizitorëve, Dizajni dhe Mbikëqyrja për sitet Turistike të Kalasë së Kaninës, Kalasë së Borshit dhe Shpellës së Spilesë. Ndërhyrje Strukturore për rritjen e stabilitetit të shpatit në Kalanë e Borshit”.

Takimi publik:

Ditën e martë 27 Qershor, ora 11:00, Himarë-fshat, ndërtesa Eco-Museum nr. 26, rruga: “Spiro Spiromilo”.

Të ftuar:

Të gjithë banorët e bashkisë Himarë, kryetar të NjA, kryetar të fshatrave, grupe interesi ne sektorin e turizmit, Kryesia e Fshatit Borsh.

Pjesëmarrës:

Përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përfaqësues nga bashkia Vlorë, përfaqësues nga bashkia Himarë (Drejtoria urbanistikës, Drejtoria përkatëse e infrastrukturës dhe investimeve publike).

Drejtuesi i takimit publik:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Nr.	Informacioni për publikun	Përshkrimi
1	Qëllimi i këshillimit publik	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, dhe Bashkia Vlorë, në kuadër të projektit “ Projekt për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmit ” me financim nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare, organizojnë Diskutimin me Publikun/ Grupet e Interesit për Projektin: “ <i>Menaxhimi, Interpretimi dhe Plani i Eksperiencës së vizitorëve, Dizajni dhe Mbikëqyrja për sitet Turistike të Kalasë së Kaninës, Kalasë së Borshit dhe Shpellës së Spilesë. Ndërhyrje Strukturore për rritjen e stabilitetit të shpatit në Kalanë e Borshit</i> ”.
2	Përshkrimi i çështjes që trajton projektakti	Takimi do të përqendrohet në prezantimin e propozimeve kryesore dhe në diskutimet potenciale me publikun dhe grupet e interesit mbi komentet dhe pikëpamjet e tyre mbi këtë Projekt. “ Vizioni për valorizimin e turizmit të siteve turistike të Kalasë së Kaninës, Kalasë së Borshit dhe shpellës të Spilesë. Plani i menaxhimit të sitit dhe identifikimi i projekteve të investimeve ”.
3	Pyetjet që ngrihen ndaj pjesëmarrësve	Të gjithë pjesëmarrësit janë të lutur të ngrenë pyetje, të trajtojnë çështjen gjerësisht mbi impaktin që ky projekt do të ketë në zonë dhe në grupet e interesit.
4	Grupet e interesit,	Qytetarë të Bashkisë dhe Njësi Administrative Himarë, grupet e interesit.
5	Adresa ku do të zhvillohet konsultimi publik	27 Qershor, ora 11:00, Himarë-fshat, ndërtesa Eco-Museum nr. 26, rruga: “Spiro Spiromilo”.
6	Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve dhe rekomandimeve	Nëpërmjet pjesëmarrjes tuaj në takimin publik , apo mund t'i dërgoni me email në adresën: bashkiahimare@yahoo.com , ose nëpërmjet postës në adresën: Adresa: L: “Spile”, Himarë, tel: 039322355, fax: 039322533,
7	Çfarë do të vijojë pas kësaj faze këshillimi	Pas përfundimit të këtij konsultimi publik, do të shqyrtohen të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet.

Ju mirëpresim në konsultimin publik.